

I nderuar Komisioner,  
E nderuar Zëvendëskryetare,  
Shkëlqesitë tuaja,  
Zonja dhe Zotërinj,

Është kënaqësi e veçantë për mua të mbaj këtë fjalë me rastin e 10-vjetorit të themelimit të Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale. Ky përvjetor shënon një moment historik të një bashkëpunimi të frytshëm midis Shqipërisë dhe Këshillit të Evropës në fushën e mbrojtjes së të dhënave.

Them moment historik, për shkak se bashkëpunimi ynë në fushën e mbrojtjes së të dhënave daton që përpara ngritjes së Zyrës së Komisionerit. Këshilli i Evropës dhe Shqipëria kanë punuar së bashku shumë kohë më përpara këtij momenti. Në kemi bashkëpunuar për përmirësimin e kuadrit ligjor dhe për ngritjen e Autoritetit të Mbrojtjes së të Dhënave dhe i kemi dhënë mbështetje nëpërmjet trajnimit të stafit pas ngritjes së tij. Jam shumë i lumtur të shoh që znj. Flora Çabej, ish-Komisionerja, e cila inicioi këto marrëdhënie të ngushta me Këshillin e Evropës, ndodhet e pranishme në celebrimin e këtij përvjetori.

Një moment historik në marrëdhënien midis KiE dhe Shqipërisë është viti 2005, kur vendi juaj ratifikoi njëkohësisht Konventën për Mbrojtjen e Personave nga Përpunimi Automatik i të Dhënave Personale (e cila njihet më tepër nga komuniteti i mbrojtjes së të dhënave si “Konventa 108”) dhe Protokollin Shtesë mbi Autoritetet mbikëqyrëse dhe qarkullimet ndërkufitare të të dhënave. Në vitin 2005, mbi 13 vite më parë, Shqipëria angazhohej në nivel ndërkombëtar për një sistem të fuqishëm të mbrojtjes së të dhënave, zbatimi i së cilit do të mbikëqyrej nga një Autoritet i pavarur i Mbrojtjes së të Dhënave. Ndërsa në atë moment mund të ketë qenë një angazhim ambicioz, sot rezultatet janë për t’u përshëndetur.

10 vite pas ngritjes së këtij institucioni kyç, ku është Shqipëria me mbrojtjen e të dhënave? Ajo po punon me efektivitet nivel kombëtar, është e mirënjohur në nivel evropian dhe ndërkombëtar dhe vazhdon të shohë përpara drejt së ardhmes dhe të bëjë përpjekje për përmirësim të vazhdueshëm të legjislacionit të saj për mbrojtjen e të dhënave, në kuadër të nisjes së zbatimit pas pak kohësh të Rregullores së Përgjithshme të Mbrojtjes së të Dhënave në të gjitha shtetet anëtare të BE, por jo vetëm dhe në kuadër të modernizimit të Konventës 108. Vërtet, 2018-a është vit kyç për mbrojtjen e të dhënave: një regjim i ri do të zbatohet në BE, i cili do të përforcojë nivelin e mbrojtjes dhe që artikullohet më së miri me modernizimin e Konventës 108, e cila shpresojmë se do të miratohet së shpejti nga Komiteti i Ministrave të Këshillit të Evropës.

Në kontekstin historik të mbrojtjes së të dhënave, 10 vite janë shumë pak për një Autoritet të mbrojtjes së të dhënave, veçanërisht kur e krahason Zyrën e Komisionerit me një Autoritet si ai francez (CNIL) p.sh, i cili celebroi 40-vjetorin e themelimit të tij dy muaj më parë. Gjithsesi, ky Autoritet i ri i Mbrojtjes së të Dhënave është mjaft i vlerësuar nga i gjithë komuniteti i mbrojtjes së të dhënave dhe do të mirëpresë homologët evropianë këtu në Tiranë në muajin maj dhe kolegë nga të gjitha rajonet e botës në vitin 2019. Duke marrë përsipër përgjegjësinë e organizimit të këtyre aktiviteteve tepër të rëndësishme, demonstron gatishmëria e këtij Autoriteti të ri për të luajtur një rol të rëndësishëm midis homologëve të tij.

Sikurse është emërtuar me të drejtë Konferenca Pranverore (Evropiane) e cila do të zhvillohet në muajin maj “Mbrojtja e të Dhënave – Mbrojmë më mirë bashkërisht”, për të mbrojtur më mirë, nevojitet bashkëpunim më i mirë.

Vërtet, sfidat me të cilat përballet Shqipëria janë sfida globale. Të dhënat personale në epokën digjitale janë shndërruar në aset për biznesin dhe në aset për qeveritë dhe mbrojtja e të dhënave personale, mbrojtja e çdo personi, varet nga institucione si Zyra e Komisionerit. Bashkëpunimi ndërmjet Autoriteteve të Mbrojtjes së të Dhënave është thelbësor për suksesin e misionit të tyre. Duhet kujtuar gjithashtu se është tepër thelbësore që institucione si ky, të gëzojnë pavarësi në ushtrimin e mandatit dhe misionit të tyre dhe se është jetike që të kenë në dispozicion burimet e nevojshme për t'i përmbushur ato. Këto aspekte të rëndësishme janë pjesë e propozimeve të modernizimit të Konventës 108, për kompetenca më të mëdha për Autoritetet e Mbrojtjes së të Dhënave, si dhe përfundim të mjeteve të bashkëpunimit dhe garantim të pavarësisë së tyre.

Që prej vitit 2014, Komisioneri është gjithashtu përgjegjës për zbatimin e së drejtës për informim në Shqipëri. Ekuilibrimi i mbrojtjes së të dhënave me aksesin në informacion nën të njëjtin institucion është praktikë e mirë, e cila ndihmon të shmangen qasjet paragjyquese dhe të njëanshme në një fushë e cila kërkon ekuilibrim të kujdesshëm. Aktiviteti që ne zhvilluam së bashku në dhjetor të vitit 2017, në kuadër të projektit “Përfundimi i ekspertizës gjyqësore mbi lirinë e shprehjes dhe median në Evropën Juglindore (JUFREX)”, aktivitet i cili kishte në fokus artikullimin sensitiv dhe të domosdoshëm midis së drejtës për privatësi dhe lirinë e shprehjes, ishte planifikuar dhe u përqendrua pikërisht në këtë optikë.

Zyra në Tiranë e KiE dhe kolegët e Njësisë së Mbrojtjes së të Dhënave në Strasburg presin me padurim të vazhdojnë punën me Zyrën e Komisionerit për forcimin e mbrojtjes së të dhënave.

Faleminderit për vëmendjen tuaj!